



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
NR.DI. NO.	01 / 650	
DATA DT.	13. 05. 2022	
	PRISHTINË - A	

KGJK. Nr. 160/2022

Datë: 28 prill 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Aziz Shaqiri dhe Naser Maliqi, gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe Ramiz Azizi, Kryetar në Gjykatën Themelore në Gjilan, sipas raportit të panelit hetimor Nr. KGJK/01/GJS-GJS-2021-015, të datës 29 mars 2022, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 28 prill 2022, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet poshtë raporti hetimor me numër Nr.AD/KGJK/01/2020/GJS-GJS-2021-015, i datës 29 mars 2022, dhe pushon procedura disiplinore ndaj Aziz Shaqiri, Naser Maliqi, gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe Ramiz Azizi, ish Kryetar në Gjykatën Themelore në Gjilan, për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore të pretenduar nga Autoriteti Kompetent.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KGJK.Nr.18/2022, të datës 21 janar 2022, i ka paraqitur me 29 mars 2022 Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin Nr.AD/KGJK/01/2020/GJS-GJS-2021-015, mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara të gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Gjilan Aziz Shaqiri, Naser Maliqi dhe Ramiz Azizi, shkelje këto të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas Autoritet Kompetent gjyqtarët në fjalë kanë kryer detyrën zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me përfundime paragjyquese, seksiste dhe ofenduese në bazë të gjinisë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore me datë 28 prill 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore ku janë dëgjuar palët në procedurë dhe është bërë administrimi i provave.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjektet e këtij hetimi pretendohet se kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës të sanksionuara me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas të gjeturave të Autoritetit Kompetent me veprimet e konstatuara në arsyetim e Aktgjykimi PKR.nr.200/2014, të datës 24 mars dhe 27 korrik 2017, të trupit gjykues të përbërë nga gjyqtaret Aziz Shaqiri, Naser Maliqi dhe Ramiz Azizi, gjyqtar të gjykatës Themelore në Gjilan, është konstatuar se gjyqtaret në fjalë kanë kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, të Ligjit Nr.06.L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KGJK duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe me pretendim të subjektit të hetimit ka vlerësuar se në rastin konkret ka ardhur deri të parashkrimi absolut i shkeljeve disiplinore të pretenduara për të tre (3) subjektet e këtij hetimi disiplinor. Nga koha e nxjerrjes së Aktgjykimit përkatës PKR.nr.200/2014, të datës 24 mars dhe 28 korrik 2017, kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore e deri me fillimin e hetimit disiplinor ndaj këtyre subjekteve ka kaluar me tepër se dy (2) vite, ndërsa Ligji Nr.05/L-003 për Plotësim Ndryshim të Ligjit Nr.03/L-223, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore, me nenin 15, paragrafi 1 (5), kishte paraparë se procedura disiplinore nuk mund të fillojë dhe të zhvillohet në Komisionin Disiplinor pasi të kalojë afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkeljen e supozuar dhe dy (2) vite nga dita e shkeljes së supozuar.

Pra në rastin konkret parashkrimi i shkeljes së supozuar disiplinore për gjyqtarët e gjykatës Themelore në Gjilan, Aziz Shaqiri, Naser Maliqi dhe ish Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan Ramiz Azizi, ka arritur me datë 28 korrik 2019, ndërsa procedura disiplinore ka filluar me 10 janar 2022.

Nga sa u tha më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.160/2022, datë: 28 prill 2022

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Venhar Salihu, Kryetar, Gjykata Themelore në Gjilan;
- Aziz Shaqiri, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjilan;
- Naser Maliqi, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjilan;
- Ramiz Azizi, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjilan;
- Arkivit.